



---

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE  
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

---

Në përputhje me nenin 1, pika 1.3 e paragrafit (ç), pika 1.7. e paragrafit (d) të Rregullores 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Duke u mbështetur në nenin 15 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe familjare Nr. 02/L-17,

Duke pasur parasysh fushëveprimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përkitazi me politikatat dhe strategjinë e shërbimeve sociale dhe familjare,  
Me qëllim të rregullimit dhe rishqyrtimit të ankesave në përputhje me procedurat administrative nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare, **Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr 04/2006**  
**PËR**  
**THEMELIMIN E KOMISIONIT PER SHQYRTIMIN DHE VENDOSJEN E**  
**ANKESAVE NË SHKALLËN E DYTË LIDHUR ME SHËRBIMET SOCIALE**  
**DHE FAMILJARE**

**Neni 1**

Qëllimi

**(1)** Udhëzimi Administrativ ka për qëllim themelimin e një komisioni për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në shkallën e dytë, lidhur me shërbimet sociale dhe familjare (në tekstin e më poshtëm Komisioni).

## **Neni 2**

### Themelimi i Komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në lidhje me shërbimet sociale dhe familjare

- (1) Komisioni themelohet në bazë të nënshkrimit të këtij Udhëzimi Administrativ nga ana e Ministrit të MPMS, në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Shërbime sociale dhe familjare.
- (2) Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes këtij Udhëzimi Administrativ e autorizon Departamentin e Mirëqenies Sociale, që në emër të Ministrisë ta themeloj Komisionin.

## **Neni 3**

### Procedurat për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në shkallë të dytë për shërbimet sociale dhe familjare

- (1) Departamenti i Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëposhtëm DMS), krijon një komision për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në shkallën e dytë lidhur me shërbimet sociale dhe familjare.
- (2) Çdo person ose përfaqësuesi i çdo personi, i cili dyshon se është diskriminuar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme, ose për arsye tjera i janë mohuar shërbimet adekuate sociale dhe familjare, ka të drejtën që të ankohet.
- (3) Në rast se një individ ose një familje janë të pakënaqur me vendimin e Qendrës për Punë Sociale (në tekstin e mëposhtëm QPS), në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, ose refuzimin e ofrimit të shërbimeve të tilla, apo nëse janë të pakënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar, mund ankohet në shkallën e dytë, respektivisht te komisioni i ankesave.
- (4) Ankesa për shkallën e dytë nga pala bëhet përmes QPS, e cila ka marrë vendim në shkallën e parë, ose mund të bëhet drejtpërdrejtë në Komisionin e DMS.
- (5) Afati për paraqitjen e ankesës në Komisionin e ankesave në shkallën e dytë është 30 ditë, nga dita kur palës i është dorëzuar vendimi i QPS.
- (6) Brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së ankesës, Komisioni e shqyrton ankesën dhe dokumentacionin përkatës dhe sipas nevojës interviston palën e pakënaqur si dhe dëshmitarët. Komisioni vendimet e veta parashtruesit të ankesës ia përcjellë me shkrim .
- (7) Vendimi i komisionit i dërgohet palës përmes QPS, e cila e ka marrë vendimin në shkallën e parë (në bazë të kompetencës territoriale), duke e njoftuar njëkohësisht edhe palën.
- (8) Nëse pala e ankuar është e pakënaqur me vendimin e Komisionit për ankesa, ai mund ta hap kontestimin administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga marrja

e vendimit të shkallës së dytë në procedurë administrative.

(9) Hapja e kontestit administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës, nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të komisionit të ankesave.

#### **Neni 4**

##### Funksionimi i komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në lidhje me shërbimet sociale dhe familjare

(1) Komisioni për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në shkallë të dytë lidhur me shërbimet sociale dhe familjare, drejtohet nga drejtori i Departamentit të Mirëqenies Sociale ose nga një person tjetër i caktuar nga ai.

Komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarëve duke llogaritur edhe kryesuesin e tij.

#### **1. Përbërja institucionale e komisionit**

Anëtarët e komisionit janë zyrtarë të këtyre institucioneve:

- 1.1** Drejtori i DMS (përfaqësuesi i caktuar nga drejtori i DMS),
- 1.2** Një drejtor i një nga QPS e vendit e cila nuk është e lidhur me rastin,
- 1.3** Një përfaqësues nga Komuna e cila nuk është e lidhur me rastin,
- 1.4** Dy përfaqësues të pavarur të emëruar nga DMS.

(2) Mbledhjet e Komisionit mund të mbahen vetëm nëse janë të pranishëm shumica e anëtarëve të Komisionit .

(3) Vendimet e Komisionit do të jenë të plotfuqishme nëse pro vendimit votojnë të paktën tre anëtar të komisionit .

#### **Neni 5**

##### Rregullativa e punës së komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në lidhje me shërbimet sociale dhe familjare

(1) Komisioni punon dhe vepron në përputhje me dispozitat e Legjislacionit nga fusha e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, si dhe dispozitat e ligjeve të aplikueshme, të cilat i rregullojnë procedurat administrative në organet e administratës.

(2) Rregullat e veçanta të punës, Komisioni mund ti rregulloi me akt nënligjor.

## Neni 6

### Kohëzgjatja e shërbimit në komisionin për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave të shkallës së dytë lidhur me shërbimet sociale dhe familjare

- (1) Mandati i shërbimit në komision është i përhershëm për të gjithë anëtarët që veprojnë nga detyra zyrtare në DMS.
- (2) Anëtarët që vijnë nga komuna dhe nga QPS, veprojnë nga rasti në rast dhe kanë mandat dy (2) vjeçar, me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.
- (3) DMS në emër të MPMS do të bëjë përzgjedhjen e pesë QPS dhe Komunave, të pesë regjioneve të Kosovës, në mënyrë që përfaqësuesit e tyre (drejtorët ose personat e autorizuar nga ata), të jenë anëtarë të komisionit kur nuk janë të lidhur me rastin.
- (4) Nëse një anëtarë i komisionit ka dështuar në kryerjen e punëve profesionale, që rrjedhin nga rregulloret e komisionit dhe pas shqyrtimit të dëshmimeve, anëtarët e komisionit mund të propozojnë përjashtimin e anëtarit që ka rënë ndesh me detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit.
- (5) Nëse një anëtar i komisionit mungon në tri mbledhje radhazi, nuk respekton ruajtjen e të dhënave të besueshme (konfidenciale), si dhe manifeston sjellje jo serioze, që bien ndesh me etikën e punës profesionale, mund të përjashtohet nga komisioni.
- (6) Në të gjitha rastet kur largohet nga përbërja e komisionit një anëtar i tij, emërohet anëtar i ri që shërben për kohën e mbetur nga mandati i anëtarit të mëhershëm. Anëtar i ri propozohet nga subjekti të cilin e ka përfaqësuar anëtar i larguar.

## Neni 7

### Institucionet përgjegjëse për punën e komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në shkallën e dytë lidhur me shërbimet sociale dhe familjare

- (1) MPMS, përkatësisht Departamenti i Mirëqenies Sociale përmes Qendrave për punë sociale është përgjegjëse, për realizimin dhe mbikëqyrjen e politikave të programit të përgjithshëm të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë, gjegjësisht për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në shkallën e dytë lidhur me shërbimet sociale dhe familjare.
- (2) Qendrat për Punë Sociale, OJQ profesionale dhe shtëpitë me bazë në komunitet, që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, janë përgjegjëse për zbatimin konkret të këtij Udhëzimi Administrativ.

## **Neni 8**

### **Hyrja ne fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Prishtinë, qershor 2006

**Ministri i MPMS**

.....  
**Ibrahim Selmanaj**